



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17/2020 regjistër (JR)
Datë 02.06.2020

Nr. 37 i vendimit
Datë 17.12.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 17.12.2020, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2020, datë 02.06.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 247, datë 05.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 127, pika 1, shkronja “c” dhe 139, pika 1, shkronja “c” e Kushtetutës; neni G i Aneksit të Kushtetutës; nenet 56, 57 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 64 e vijues i ligjit nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar .

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të saj ligjor, avokat Loren Liço, të cilët kërkuan ndryshimin

pjesërisht të vendimit nr. 247, datë 05.03.2020, duke hequr si të pabazuar urdhërimin në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Në datën 09.01.2020, znj. Arjana Liço i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) kërkesën për dorëheqjen e parevokueshme nga statusi i magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së detyruar për pension pleqërie.
3. Në datën 23.01.2020, me vendimin nr. {***}, KLGj-ja vendosi: “Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për znj. Arjana Liço, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status”.
4. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar të znj. Arjana Liço, me vendimin nr. 247, datë 05.03.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 247, datë 05.03.2020, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës vendosi:
 1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, është ndërprerë.
 2. Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
 3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 [...].

III. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit nr. 247, datë 05.03.2020, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe deklarin të përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar për të, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, duke paraqitur shkaqet e ankimit si më poshtë.

6.1 Lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni është shkelur neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, dhe neni 42, pika 2 e Kushtetutës, pasi vendimmarrja është arritur në mungesë të një procesi të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i shortuar për procesin e rivlerësimit dhe nuk është vënë në dijeni as për procesin që po zhvillohej ndaj tij, as për përbërjen e trupit gjykues. Në këtë mënyrë, nuk i është dhënë mundësia për të parashtruar pretendimet e tij për këtë proces, i cili ka sjellë një vendimmarrje të gabuar ndaj tij.

6.2 Lidhur me themelin e çështjes, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, duke deklaruar humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, i ka vendosur një sanksion administrativ në kundërshtim me ligjin, të pazbatueshëm dhe absurd, për arsye se:

a. Moshja e detyruar për pension pleqërie për gjyqtarin e shkallës së parë dhe të apelit, është e përcaktuar vetëm në vendimin nr. 34, datë 18.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe subjekti i rivlerësimit, duke respektuar në mënyrë rigorozë ligjin, pasi ka mbushur më datë 07.01.2020 moshën 65 vjeç dhe ka punuar në mënyrë të pandërprerë për një periudhë 43 vjet e gjashtë muaj, ka paraqitur para KLGj-së kërkesën për mbarimin e statusit të gjyqtarit, bashkëlidhur dhe kërkesën për pension pleqërie, duke hequr dorë nga ky status me vullnetin e saj të lirë, për të dalë në pension para mbarimit të mandatit të përcaktuar në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

b. Komisioni ka interpretuar gabim nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dalja në pension pleqërie, si e drejtë themelore e parashikuar në nenin 52, pika 1 e Kushtetutës, nuk mund të konsiderohet dorëheqje nga detyra në kuptim të këtij neni. Humbja e së drejtës së emërimit për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 15 vjeçare, kur ajo është në pension pleqërie me vullnetin e saj të lirë, duke mos qenë më subjekt rivlerësimi, është e pakuptimtë dhe e pazbatueshme. Në këto kushte, duhet deklaruar i përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur;

c. Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit, në ndryshim nga vendimmarrje të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, të cilat kanë dalë në pension pleqërie në zbatim të vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

7. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, në mbështetje të pretendimeve të saj, bashkëlidhur ankimit paraqiti disa akte shkresore¹.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Trupi gjykues, në verifikim të kërkesave të nenit të sipërcituar në raport me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço, edhe pse ajo nuk kishte kërkuar shprehimisht që Kolegji të shqyrtojë çështjen e saj në seancë gjyqësore publike, konstatoi se subjekti ka pretenduar shkelje të rënda procedurale gjatë zhvillimit të procesit në Komision, të cilat sipas saj cenojnë procesin e rregullt ligjor.

9. Lidhur me aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit², nga verifikimi i akteve që gjenden në fashikullin e gjykimit, i krijuar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi

¹ - Vërtetim nr. {***} prot., datë {***}, i DRSSH Tiranë.

- Njoftim vendimi nr. 247, datë 05.03.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, me nr. {***} prot., datë 11.05.2020.

- Vendimi nr. 247, datë 05.03.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, me nr. {***} prot., datë 05.03.2020.

² Aktet e sipërcituara.

gjykues konstatoi se vendimi nr. 247, datë 05.03.2020, i Komisionit, si dhe njoftimi i këtij vendimi të Komisionit të subjekti, gjenden të administruar në fashikull dhe, për pasojë, asnjë prej tyre nuk plotëson kërkesat e një prove të re, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

10. Për sa i përket aktit vërtetimi nr. {***} prot., datë {***}, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, sipas të cilit vërtetohet se znj. Arjana Liço, e datëlindjes {***}1955, me numër dosjeje {***}, trajtohet me pension pleqërie me datë fillimi pensioni 24.01.2020, trupi gjykues, në dhomë këshillimi, vlerësoi se përmbush kërkesat e një prove të re, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk është njoftuar për procedurën e zhvilluar ndaj tij dhe nuk është thirrur në seancë dëgjimore publike, për të pasur mundësi që ta paraqiste këtë provë në Komision. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, çështja duhet të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit.
11. Në lidhje me shkakun e ankimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni është shkelur neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së dhe neni 42, pika 2 e Kushtetutës, pasi nuk ka qenë i shortuar për procesin e rivlerësimit dhe nuk është vënë në dijeni se ndaj saj po zhvillohej një proces, nuk është vënë në dijeni as për përbërjen e trupit gjykues e në këtë mënyrë nuk i është dhënë mundësia për të parashtruar pretendimet e saj për këtë proces, nga verifikimi i akteve të fashikullit, trupi gjykues konstatoi se:
 - (i) Sipas procesverbalit të mbledhjes së zhvilluar nga trupi gjykues i Komisionit, më datë 05.03.2020, çështja që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço, është shqyrtuar në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, pa thirrur në seancë dëgjimore publike, subjektin e rivlerësimit.
 - (ii) Në vendimin nr. 247, datë 05.03.2020, në paragrafin 22 të tij, Komisioni është shprehur: “22. Në zbatim të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (shkronja “d” e tij). Duke qenë se neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon ndërprerjen në rast dorëheqjeje nga detyra, ndërprerja e procesit bëhet pa u zhvilluar seanca dëgjimore”.
12. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, si dhe në nenin 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*, proces i cili ka filluar menjëherë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është shkelur neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së dhe neni 42, pika 2 e Kushtetutës, pasi nuk ka qenë i shortuar për procesin e rivlerësimit dhe nuk është vënë në dijeni se ndaj tij po zhvillohej një proces, është i pabazuar.
13. Në vendim³, Komisioni ka argumentuar mungesën e zhvillimit të seancës dëgjimore duke iu referuar shkronjës “d” të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, e cila përcakton mbylljen e procedurës administrative pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, vetëm në rast se një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht me ligj. Plotësimin e këtij kushti, Komisioni e ka lidhur me përmbajtjen e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, i cili meqenëse parashikon ndërprerjen e procesit të rivlerësimit në rast dorëheqjeje nga detyra, legjitimon ndërprerjen e procesit pa i dhënë të drejtën subjektit për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore. Trupi gjykues, në analizë të arsyetimit të sipërcituar të Komisionit, vlerëson se ligji i posaçëm që rregullon elementet procedurale të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, ligji nr. 84/2016, në nenin 55, pikat 1 dhe 2, parashikon zhvillimin e seancës dëgjimore publike si rregull i përgjithshëm i

³ Paragrafi 22 i vendimit të Komisionit.

zhvillimit të procedurës së rivlerësimit. Përrjashtimi nga ky rregull mund të vijë vetëm si rezultat i rrethanave në plotësim të njërit apo disa rasteve përjashtimore të parashikuara nga neni 89 i Kodit të Procedurave Administrative. Shkronja “d” e nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, e referuar nga Komisioni në vendim, nuk gjen zbatim në procesin e rivlerësimit, pasi neni G i Aneksit të Kushtetutës⁴ parashikon të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si dhe pasojat e drejtpërdrejta të saj mbi procesin e rivlerësimit e mbi statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit. Parashikimet e këtij neni, në asnjë moment, nuk shprehen në lidhje me elemente procedurale të zhvillimit të procedurës administrative, në rastin e dorëheqjes, e aq më tepër të referojnë në mënyrë të shprehur mbylljen e procedurës administrative pa u dëgjuar subjekti i rivlerësimit.

Trupi gjykues konstatoi se, referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, nuk është provuar as ekzistenca e ndonjë prej rasteve të tjera përjashtimore të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative.

14. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur në aktin e dorëheqjes së saj drejtuar KLGj-së ndonjë mendim⁵ në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe vullnetin për ta ndërprerë atë, referuar vendimit orientues të Kolegjit nr. 1/2018 (JR), si një kriter i cili mund ta klasifikojë dorëheqjen e subjekteve nga detyra si një rast përjashtimor për moskryerjen e seancës dëgjimore nga Komisioni.
15. Në përfundim të sa më sipër, bazuar edhe në rrethanat e sipërcituara, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se vendimmarrja e Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit dhe dhënien e ndalimit të ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për periudhën kohore prej 15 vitesh, në mungesë të njoftimit të subjektit të rivlerësimit, pa i bërë të ditur rezultatin e prishëm të kësaj procedure dhe pa i dhënë asaj të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore në lidhje me arsyet e dhënies së dorëheqjes nga statusi i magjistratit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të cenimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar lidhur me çështjen, sipas përcaktimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
16. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të kompetencave korrigjuese lidhur me gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, parashikuar shprehimisht në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e tij mbi procesin e rivlerësimit, të cilat do t’i kishte dhënë përpara Komisionit, në mënyrë të veçantë lidhur me arsyet e dhënies së dorëheqjes nga statusi i magjistratit dhe efektet që passjell në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar kjo dorëheqje.

⁴ Neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.”

⁵ Sipas vendimit orientues të Kolegjit nr. 1/2018 (JR), paragrafi 55: “Paraqitja sipas ligjit e aktit të dorëheqjes, i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme dhe, si e tillë, bën pjesë të rastet përjashtimore, në kushtet kur edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është dhënë në dorëheqjen e paraqitur [...]”.

17. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, seanca gjyqësore publike e datës 14.12.2020 u zhvillua në prani të subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij Loren Liço, të cilët parashtruan para Kolegjit shkaqet e ankimit, si dhe pretendimet e tyre lidhur me vendimin nr. 247, datë 05.03.2020, të Komisionit. Në seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, për të mbështetur pretendimet e parashtruara prej saj në ankim, paraqiti disa akte⁶ të cilat kërkoi që të merreshin në cilësinë e provës. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45, 49, 50 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të pranojë marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi ligjor i saj, avokat Loren Liço, kërkuan përfundimisht pranimin e ankimit.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për themelin

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim, si dhe në parashtrimet e paraqitura në seancën publike në Kolegj, se Komisioni, duke deklaruar humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, i ka vendosur një sanksion administrativ në kundërshtim me ligjin, të pazbatueshëm dhe absurd, për arsye se Komisioni ka interpretuar gabim nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dalja në pension pleqërie, si e drejtë themelore e parashikuar në nenin 52, pika 1 e Kushtetutës, nuk mund të konsiderohet dorëheqje nga detyra në kuptim të këtij neni – pretendim për të cilin, trupi gjykues konstatoi si vijon.
19. Znj. Arjana Liço, në cilësinë e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 09.01.2020, ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Kërkesë”, me anë të së cilës ka paraqitur dorëheqjen e parevokueshme nga statusi i magjistratit, me argumentin se ka mbushur moshën e detyruar për pension pleqërie, referuar ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe standardit kushtetues të vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese. Bashkëlidhur kërkesës, gjyqtarja ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, sipas të cilit znj. Arjana Ll. Liço ka paraqitur kërkesën për pension pleqërie/suplementar dhe është regjistruar me nr. {***}, datë {***}, në ALSSH të Tiranës. Bashkëlidhur vërtetimit gjendet edhe formulari i kërkesës për caktim pensioni pleqërie të kërkueses Arjana Liço.
- Më datë 10.01.2020, gjyqtarja ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor “Kërkesë”, me anë të së cilës ka kërkuar që të shqyrtohet në një kohë sa më të shkurtër kërkesa e saj e paraqitur më datë 09.01.2020 për dorëheqje të parevokueshme, bazuar në nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi sipas kërkesës nr. {***}, datë {***}, i fillon pensioni i pleqërisë më datë 09.01.2020.
- Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave, KLGj-ja ka marrë vendimin nr. {***}, datë 23.01.2020, me anë të të cilit ka vendosur “Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për znj. Arjana Liço, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status”⁷. Ky vendim i KLGj-së rezulton të mos jetë ankimuar nga znj. Arjana Liço, sipas informacionit të përcjellë nga KLGj-ja në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2020.

⁶ - Vërtetimin nr. {***} prot., të datës {***}, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, të cilin trupi gjykues e kishte, ndaj iu kthye sërish subjektit.

- Fotokopje e njësuar me origjinalin në të cilën gjendet vendimi nr. 23, datë 09.08.2005, i Këshillit Bashkiak Krujë, nëpërmjet të cilit subjektit i është dhënë titulli “Qytetar nderi i Krujës”. Bashkëngjitur saj edhe fotokopje e noterizuar e miratimit të Prefektit të Qarkut Durrës, i datës 22.08.2005.

- Kopje e librezës së punës të subjektit të rivlerësimit, fotokopje e noterizuar.

⁷ Pika 1 e vendimit nr. {***}, datë 23.01.2020, të KLGj-së.

20. Në vlerësim të gjithë situatës faktike të përshkruar më sipër, Komisioni ka vendosur të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, është ndërprerë, si dhe të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Komisioni, në vendimin e tij⁸, ka arsyetuar lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço, se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status, pra i gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Arjana Liço. Gjithashtu Komisioni ka theksuar se Kolegji i Posaçëm Apelimit, gjatë praktikave të gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, ka orientuar për respektimin e parimit të transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, për verifikimin e vullnetit të pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj, si dhe për vendosjen në raste të tilla të ndalimit të emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
- Subjekti i rivlerësimit, në ankim si dhe gjatë parashtrimeve të tij në seancën publike në Kolegj, ka pretenduar se Komisioni, duke deklaruar humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, i ka vendosur një sanksion administrativ në kundërshtim me ligjin, të pazbatueshëm dhe absurd, për arsye se:
- (i) moshë e detyruar për pension pleqërie për gjyqtarin e shkallës së parë dhe të apelit, është e përcaktuar vetëm në vendimin nr. 34, datë 18.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe subjekti i rivlerësimit, duke respektuar në mënyrë rigoroze ligjin, pasi ka mbushur më datë {***}2020 moshën 65 vjeç dhe ka punuar në mënyrë të pandërprerë për një periudhë prej 43 vjetësh e gjashtë muajsh, ka paraqitur para KLGj-së kërkesën për mbarimin e statusit të gjyqtarit, bashkëlidhur dhe kërkesën për pension pleqërie, duke hequr dorë nga ky status me vullnetin e saj të lirë, për të dalë në pension para mbarimit të mandatit të përcaktuar në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar;
- (ii) Komisioni ka interpretuar gabim nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dalja në pension pleqërie, si e drejtë themelore e parashikuar në nenin 52, pika 1 e Kushtetutës, nuk mund të konsiderohet dorëheqje nga detyra në kuptim të këtij neni. Humbja e së drejtës së emërimit për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 15 vjeçare, kur ajo është në pension pleqërie me vullnetin e saj të lirë, duke mos qenë më subjekt rivlerësimi, është e pakuptimtë dhe e pazbatueshme. Në këto kushte, duhet deklaruar i përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
21. Në analizë të këtij shkakut ankimi në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ligji nr. 96/2016, në pikën 1, shkronja "c" e nenit 64, para ndryshimeve, të miratuara me ligjin nr. 48/2019, kishte një formulim të ndryshëm, duke parashikuar si një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, mbushjen e moshës së pensionit. Ndërsa, pika 5 e po këtij neni parashikonte se: *Magjistratit, i cili plotëson kushtet e parashikuara në ligj për të dalë në pension, i mbaron statusin e magjistratit në fund të muajit në të cilin ka mbushur moshën për pension. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës.*

⁸ Paragrafët 12, 13 dhe 14 të vendimit të Komisionit.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 34/2017, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 4 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, të sipërcituar, duke arsyetuar: *Në lidhje me magjistratët e tjerë, ligji në pikën 5 të nenit 64 parashikon se statusi i tyre mbaron në fund të muajit në të cilin kanë mbushur moshën e pensionit, kur ata plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj për të dalë në pension. Po ashtu, Gjykata konstaton se ligji në nenin 27 ka parashikuar mbushjen e moshës 60 vjeç si kufirin për të përfutur pension të parakohshëm. Bazuar në interpretimin literal të normës, Gjykata vlerëson se ligjvënësi përmes përdorimit të shprehjes “kushtet e parashikuara në ligj” e ka lidhur daljen në pension të magjistratit me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që parashikon kuadri ligjor për pensionet në Republikën e Shqipërisë. Duke e analizuar rregullimin ligjor për pensionin e pleqërisë së magjistratëve në kontekstin e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës zbatimi i normës ligjore, sipas formulimit aktual, ngre dyshime serioze për mosrespektimin e disa parimeve kushtetuese. Konkretisht, ligjvënësi, duke ulur moshën e daljes në pension nga 65 vjeç që ishte më parë, në një moshë të papërcaktuar shprehimisht, por të përcaktueshme rast pas rasti nga kuadri ligjor për pensionet e pleqërisë në RSH-së, ka krijuar një gjendje pasigurie juridike në radhët e magjistratëve [...]. Nga ana tjetër, prania e parashikimeve ligjore të paharmonizuara për pensionin e parakohshëm dhe atë të pleqërisë, ku për të dyja rastet moshë e përcaktuar nga ligjvënësi është 60 vjeç, si dhe rreziku i trajtimit të pabarabartë të gjyqtarëve për shkak të gjinisë, pasi, sipas legjislacionit në fuqi, moshë e daljes në pension e femrave ndryshon nga ajo e meshkujve, në vlerësimin e Gjykatës përbëjnë arsye bindëse për të arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesve për papajtueshmërinë me nenin 18 dhe 138 të Kushtetutës të nenit 64, pika 5 është i bazuar dhe duhet pranuar⁹.*

Në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi ka bërë ndryshime në nenin 64, “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit”, të ligjit nr. 96/2016, me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 48/2019, duke parashikuar se:

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

c) mbush moshën 67 vjeç;

ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën [...].

5. Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Në nenin 27, pika 1, shkronja “a” e po këtij ligji, parashikohet moshë 60 vjeç, si moshë e daljes në pension të parakohshëm të magjistratit.

22. Në analizë të bazës ligjore të sipërcituar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, nuk ka përcaktuar asnjë moshë detyruese për daljen në pension të gjyqtarëve apo prokurorëve¹⁰. Në zbatim të të drejtës kushtetuese për gëzimin e një pensioni pleqërie¹¹, edhe ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 7703/1993”), nuk ka përcaktuar një moshë detyruese për pension pleqërie, por ka parashikuar të drejtën e çdo personi për të përfutur pension pleqërie me arritjen e një moshe të caktuar sipas përcaktimeve të posaçme në ligj.

⁹ Paragrafët 49 dhe 50 të vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰ Përfutur këtu vetëm gjyqtarët e Gjykatës së Lartë apo Prokurorit të Përgjithshëm që sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 dalin në pension në moshën 70 vjeç.

¹¹ Neni 51, pika 1 e Kushtetutës.

Trupi gjykues në Kolegj vlerësoi se legjislacioni për statusin e magjistratit ka parashikuar mbarimin e statusit të magjistratit në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç, duke i dhënë mundësinë atij të qëndrojë në detyrë, pavarësisht mbushjes së moshës për të përfituar pensionin e pleqërisë, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për pensionet sipas skemës së sigurimeve të detyrueshme shoqërore. Parashikimet e nenit 64, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, nuk duhen interpretuar në asnjë rast si detyruese për magjistratin, por si lejuese, në kuptimin që pavarësisht moshës së lejuar nga ligji për sigurimet shoqërore për të përfituar pension pleqërie, magjistrati, nëse e vlerëson të nevojshme, mund të qëndrojë në detyrë përtej kësaj moshe, nëse ajo është më e ulët se mosha 67 vjeç, e parashikuar si kufiri maksimal moshor për të ushtruar statusin e magjistratit. Një interpretim i ndryshëm do të binte në kundërshtim me nenin 51, pika 1 e Kushtetutës, e cila parashikon se: “1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Në kushtet e parashikimeve të reja ligjore, kur mbushja e moshës së pensionit të pleqërisë nuk renditet si një nga shkaqet e mbarimit të statusit, mbetet në vlerësimin e magjistratit se kur do të ushtrojë të drejtën e tij për daljen në pension, në datën e parashikuar nga ligji nr. 7703/1993 për sigurimet shoqërore apo kur të mbushë moshën 67 vjeç. Po ashtu, mbetet në vlerësimin e tij nëse ai do të ushtrojë të drejtën për qëndrimin në detyrë dhe, për rrjedhojë, të gëzojë edhe statusin e magjistratit deri në moshën 67 vjeç apo nuk do të qëndrojë më në detyrë, duke dhënë dorëheqjen prej statusit të magjistratit sipas nenit 64, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 65 të ligjit nr. 96/2016.

Në vlerësim të akteve të administruara në Komision por edhe në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, ka ushtruar këtë të drejtë kushtetuese duke paraqitur kërkesën për dalje në pension pleqërie pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ditën që ka mbushur moshën 65 vjeç, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke shprehur në këtë mënyrë vullnetin e saj për të mos ushtruar të drejtën për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, edhe për të mos gëzuar statusin magjistratit deri në mbushjen e moshës 67 vjeç.

23. Në çështjen objekt shqyrtimi, Komisioni, në vendim, ka konstatuar se “subjekti ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën nr. {***} prot., datë 9.1.2020, për mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së detyruar për pension pleqërie, dhe ka aplikuar pranë DRSSH-së Tiranë për lidhjen e pensionit të pleqërisë, meqenëse në datën 9.1.2020 i filloi pensioni i pleqërisë, si dhe ka depozituar kërkesën për pension pleqërie nr. {***}, datë {***}”, por nuk i ka dhënë vlerë këtij fakti, duke konsideruar vetëm dorëheqjen e dhënë nga subjekti para KLGj-së. Trupi gjykues vlerësoi se me të drejtë Komisioni nuk i ka dhënë vlerë depozitimit në datë 9.01.2020, të kërkesës për pension pleqërie nga subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço. Gjithashtu, edhe vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, dorëheqjen e saj të paraqitur në datën 9.01.2020, në KLGj, pavarësisht arsyeve të parashtruara në të, e ka bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, duke pranuar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes. Bazuar në sa është interpretuar në paragrafin 22 të këtij vendimi, mbushja e moshës për pension pleqërie nuk është parashikuar në nenin 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, si një nga rastet kur mbaron statusi i magjistratit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se mbarimi i statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, ka ardhur për shkak të dorëheqjes së saj, dhe konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit.
24. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *humbja e së drejtës së emërimit për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 15-vjeçare, kur ajo është në pension pleqërie me vullnetin e saj të lirë, duke mos qenë më subjekt rivlerësimi, është e pakuptimtë dhe e pazbatueshme*, trupi gjykues vëren se pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka mbushur moshën 65 vjeç dhe është fakt që prej 24.01.2020 po gëzon pensionin e pleqërisë, ajo përsëri mund të ushtrojë të drejtën e punësimit në përputhje me përcaktimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislacionit të sigurimeve

shoqërore, ligjit nr. 96/2016 apo ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”).

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se sipas neneve 125, pika 4; 136, pika 3; 147, pika 4; si dhe 149, pika 4 e Kushtetutës, individët me eksperiencë pune prej të paktën 15 vjetësh, si gjyqtarë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, apo jurist me një veprimtari të spikatur në një fushë të së drejtës etj., kanë mundësinë të përzgjidhen si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo Prokuror i Përgjithshëm. Në dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilat rregullojnë mbarimin e mandatit për pozicionin e gjyqtarëve në gjykatat e sipërcituara, Prokurorit të Përgjithshëm apo anëtarëve të këtyre institucioneve kushtetuese, si dhe në ligjet¹² që kanë dalë në zbatim të këtyre dispozitave, është përcaktuar se mandati i tyre përfundon, apo ata mund të dalin në pension pleqërie, me mbushjen e moshës 70 vjeç. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se sipas nenit 64, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dalin në pension kur mbushin moshën 70 vjeç, ndërsa sipas neneve 4, pika 2 dhe 102, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë gëzojnë përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, duke gëzuar në këtë mënyrë dhe përfitimin e pensionit të pleqërisë në të njëjtat kushte si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Referuar përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, magjistratët kanë të drejtë të dalin në pension të parakohshëm në moshën 60 vjeç. Përpos këtij parashikimi, sipas nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 7703/1993, personat e siguruar, përfshirë këtu edhe magjistratët që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji. Gjithashtu, në nenin 33 të ligjit nr. 7703/1993, përfituesi i pensionit të pleqërisë, përfshirë këtu edhe i pensionit të parakohshëm të pleqërisë, i cili ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë i llogaritet përfituesit mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes, pra gjatë kohës që ai është ekonomikisht aktiv me statusin e të punësuarit apo të vetëpunësuarit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se përfituesi i pensionit të pleqërisë nuk është i lidhur pazgjidhshmërisht me gëzimin e kësaj të drejte, por ai ka të drejtën që përsëri të jetë një person ekonomikisht aktiv, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, duke ndërprerë vazhdimin e gëzimit të pensionit të pleqërisë dhe duke paguar kontribute për sigurimin e detyrueshëm shoqëror me këtë status të ri punësimi, si dhe rikthimin përsëri për gëzimin e pensionit. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, edhe pse është përfituese e pensionit të pleqërisë prej datës 24.01.2020, nëse ajo plotëson kriteret për gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtare të Gjykatës së Lartë, anëtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo për Prokurorë e Përgjithshme, ka mundësi që të ndërpresë pensionin e pleqërisë dhe të zgjidhet në një nga detyrat e sipërcituara dhe, me arritjen e moshës 70 vjeç, të rikthehet përsëri si përfituese e pensionit të pleqërisë. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ndalimi i vendosur në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës merr kuptim dhe bëhet i zbatueshëm edhe për magjistratët të cilët japin dorëheqjen për arsye të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, përfshirë këtu edhe ata që kërkojnë të përfitojnë pension të parakohshëm pleqërie. Sa i përket periudhës 15 vjeçare të ndalimit, trupi gjykues vlerëson se ligjvënësi, me përcaktimin në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk u ka lënë asnjë

¹² Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”.

diskrecion institucioneve të rivlerësimit lidhur me periudhën që duhet të zbatohet rast pas rasti për subjektet e rivlerësimit.

25. Në analizë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço, se *Komisioni ka interpretuar gabim nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dalja në pension pleqërie si e drejtë themelore e parashikuar në nenin 52, pika 1 e Kushtetutës, nuk mund të konsiderohet dorëheqje nga detyra në kuptim të këtij neni. Humbja e së drejtës së emërimit për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 15-vjeçare, kur ajo është në pension pleqërie me vullnetin e saj të lirë, duke mos qenë më subjekt rivlerësimi, është e pakuptimtë dhe e pazbatueshme*, trupi gjykues, duke mbajtur parasysh edhe jurisprudencën e Kolegjit, arsyeton se dorëheqja nga statusi i magjistratit në kuptim të ligjit nr. 96/2016, sjell për pasojë dhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit. Kolegji ka arsyetuar gjithashtu se vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Nëse subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar, jep dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, ai duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Në rastet kur subjektet e rivlerësimit *ex officio* heqin dorë nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit, ata vendosen në kushtet që ndaj tyre duhet të gjejë zbatim neni G i Aneksit të Kushtetutës, ku shprehimisht parashikohet: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 78, datë 12.12.2017, ku arsyeton se: *Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë zbatimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës nga ana e Komisionit, duke vendosur ndalimin e subjektit nga e drejta për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

26. Bazuar në gjithë sa është arsyetuar më sipër, trupi gjykues, pasi vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm, arrin në përfundimin se subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço, i ka mbaruar statusi i magjistratit, mbështetur në nenin 64, pika 1 germa “a” dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, me dorëheqjen e paraqitur prej saj para Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke iu ndërprerë procesi i rivlerësimit dhe vendosur në kushtet e nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15- vjeçare.
27. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbatim të gabuar të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, gjendet i pabazuar dhe, për rrjedhojë, vendimi i Komisionit

për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit duke e vendosur subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço, në kushtet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 247, datë 05.03.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.12.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues në Kolegj, për lënien në fuqi të vendimit nr. 247, datë 5.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni") që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Liço.
2. Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke qenë subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, *ex officio*.
3. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja në gjykim, referuar provave të administruara, ka rezultuar se më datë 24.01.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor informoi Komisionin se pas shqyrtimit të kërkesës për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, me vendimin nr. {***}, datë 23.1.2020, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për zonjën Arjana Liço, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. Komisioni, pasi është njoftuar nga KLGj-ja, dhe ka administruar dosjen e cila ka shërbyer për marrjen e vendimit për deklarin e mbarimit të mandatit të znj Arjana Liço, ka çmuar se konfirmohet vullneti i subjektit për dorëheqje para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe më pas ky këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit.
5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Liço, nisur nga gjendja e saj shëndetësore, ka çmuar se ka plotësuar moshën sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe është dorëhequr nga statusi i magjistratit për shkak të fillimit të pensionit të pleqërisë.
6. Nga dokumentacioni që përmban dosja gjyqësore, nuk rezulton që Komisioni të kishte filluar më përpara hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Liço.
7. Gjithashtu, nuk ka rezultuar që Komisioni t'i ketë dërguar pyetësorë në kuadër të hetimit administrativ apo t'i ketë kaluar barrë prove mbi kriteret e vlerësimit. Nuk rezulton gjithashtu të jenë depozituar kërkesa për shtyrjen e hetimit administrativ në Komision nga subjekti, siç ka ndodhur në disa raste të ankimuar në Kolegj, për të tentuar shmangien nga procesi i rivlerësimit.
8. Për sa më sipër, nisur dhe nga parashtrimet dhe deklarinet e subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore publike përpara trupit gjykues në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, krijova bindjen time se duhet të ndryshohet vendimi i Komisionit për pikën 2 të dispozitivit të tij.

Gjyqtare

Natasha MULAJ

nënshkrimi